# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2025 – Numri: 134

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E hënë, 28 korrik 2025**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Dekret i Presidentit nr. 254, datë 22.7.2025 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare............................................................ | 19275 |
| Dekret i Presidentit nr. 255, datë 22.7.2025 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare............................................................ | 19275 |
| Dekret i Presidentit nr. 256, datë 22.7.2025 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare............................................................ | 19275 |
| Dekret i Presidentit nr. 257, datë 22.7.2025 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare............................................................ | 19275 |
| Dekret i Presidentit nr. 258, datë 22.7.2025 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare............................................................ | 19276 |
| Dekret i Presidentit nr. 259, datë 22.7.2025 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare............................................................ | 19276 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 412, datë 23.7.2025 | Për transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Elbasan, të pronës nr. 279, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr. 5012/38”, me numër pasurie 17/65, në zonën kadastrale 8522, për një shtesë në vendimin nr. 416, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar............... | 19276 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 413, datë 23.7.2025 | Për transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër të pronës, me emërtimin “Godina Tatim-Taksa Shkodër”, me numër rendor 861, dhe për një shtesë në vendimin nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës”, të ndryshuar.................................................................................................... | 19279 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 415, datë 23.7.2025 | Për ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për krijimin e hapësirave të reja për arkivin e Kryeministrisë...................................... | 19287 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 23.7.2025 | Për një shtesë në vendimin nr. 725, datë 2.9.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar............................. | 19287 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 422, datë 23.7.2025 | Për transferimin në pronësi të Korporatës së Investimeve Shqiptare të pasurisë shtetërore nr. 867/7, në zonën kadastrale 1604, për realizimin e projektit të investimit *"Expo Albania"*................................ | 19288 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 423, datë 23.7.2025 | Për financimin e Federatës Shqiptare të Skive për mbështetje dhe përgatitje për pjesëmarrje në Lojërat Olimpike Dimërore *Milano Cortina* 2026....................................................................................... | 19289 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 424, datë 23.7.2025 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 893, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e projektit 'Ekipet sportive në shkolla', në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare, dhe për aktivitete në kuadër të ndërkombëtarizimit të sporteve të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)", të ndryshuar...................................... | 19289 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 23.7.2025 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 110, datë 19.2.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2025"................................................................ | 19290 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 696, datë 17.7.2025 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë................................................ | 19290 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 697, datë 17.7.2025 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Ukrainës................................................ | 19293 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 698, datë 17.7.2025 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Polonisë................................................ | 19296 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 699, datë 17.7.2025 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Bosnjë-Hercegovinës........................... | 19299 |

**DEKRET**
**Nr. 254, datë 22.7.2025**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Okan Tuncay Karakaya

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Bajram Begaj**

**DEKRET**
**Nr. 255, datë 22.7.2025**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Scott Robert David Locke Graham Elliott

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Bajram Begaj**

**DEKRET**
**Nr. 256, datë 22.7.2025**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar", me propozim të Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Gökhan Nuh Elkaya

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Bajram Begaj**

**DEKRET**
**Nr. 257, datë 22.7.2025**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Ibrahim Sefer Eraslan

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Bajram Begaj**

**DEKRET**
**Nr. 258, datë 22.7.2025**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:
1. Ilkay Vildan Alkaya

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Bajram Begaj**

**DEKRET**
**Nr. 259, datë 22.7.2025**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:
1. Nina Matvii Ovsiannikova

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Bajram Begaj**

**VENDIM**
**Nr. 412, datë 23.7.2025**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK BASHKIA ELBASAN, TË PRONËS NR. 279, ME EMËRTIM "ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5012/38", ME NUMËR PASURIE 17/65, NË ZONËN KADASTRALE 8522, PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 416, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar,

me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Elbasan, të pronës nr. 279, me emërtim "Ish-reparti ushtarak nr. 5012/38", me numër pasurie 17/65, në zonën kadastrale 8522, sipas formularit dhe plan-rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për t'u përdorur në funksion të projektit "Dua të luaj".

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 416, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Elbasan, të Qarkut të Elbasanit", të ndryshuar.

3. Prona nr. 279, me emërtimin "Ish-reparti ushtarak nr. 5012/38", hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.

4. Bashkisë Elbasan i ndalohet ndryshimi i destinacionit dhe tjetërsimi i pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Elbasan dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

FORMULARI I PËRDITËSIMIT

Ministria e Mbrojtjes

Reparti Ushtarak Nr. 4001

Identifikoi: Major Izet **Kamberi**, Specialist për Pronat, Rep. Usht. Nr. 4001
Major Tefik **Kambo**, Shef i Financës së Rep. Usht. Nr. 4006
Major Gazmend **Llangozi**, Specialist Logjistike në Rep. Usht. Nr. 4006

Supervizoi: Nënkolonel Arijan **Shkurta**, Shef i Sektorit të Pronave, Rep. Usht. Nr. 4001

Aprovoi: Gjeneral brigade Aleksandër **Pando**, Komandant i Rep. Usht. Nr. 4001

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMANDA E MBËSHTETJES REPARTI USHTARAK NR. 4001 MINISTRIA E MBROJTJES TIRANË

| Nr. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Pasurisë | Emërtesa e pasurisë<br>Adresa | Sip. e pasurisë (m2) | Nga Sip. Truall (m2) | Nga Sip. Ndërtesë (m2) | Funksioni për të cilin përdoret prona/ pasuria | Institucioni me përgjegjësi administrative / pronësi | Institucioni përdorues i pasurisë<br>Statusi juridik i përdorimit | Inventarizuar me VKM | Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 279 | 8522 | 17/65 | Truall | Ish Rep. Usht. Nr. 5012/38. Shkumbin, Elbasan | 23833.9 | 23833.92 | 2574.9 | Për mbrojtjen | Reparti Ushtarak Nr. 4001 | Reparti Ushtarak Nr. 4006 | VKM nr. 515, datë 18.07.2003, ndryshuar me VKM nr. 220, datë 21.03.2017 | |
| | | | Ndërtesë | Objekti nr.1 | | | 665.4 | | | | | |
| | | | Ndërtesë | Objekti nr.3 | | | 373 | | | | | |
| | | | Ndërtesë | Objekti nr.4 | | | 375.7 | | | | | |
| | | | Ndërtesë | Objekti nr.5 | | | 375.7 | | | | | |
| | | | Ndërtesë | Objekti nr.6 | | | 375 | | | | | |
| | | | Ndërtesë | Objekti nr.7 | | | 410.1 | | | | | |
| TOTAL | | | | | 23833.9 | 23833.92 | 2574.9 | | | | | |

**PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE**
Prona nr. 279 "Ish Reparti Ushtarak Nr. 5012/38" Shkumbin, Elbasan

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM — DATË 29.05.2025 — QËLLIMI : Përditësim/Transferim

VENDNDODHJA
Bashkia Elbasan — DVASHK Elbasan — Nr.Pasurisë 17/65 — Z.K 8522 — Indeksi i Hartës EL; Q-10; P-10

TE DHËNAT E PASURISË
Lloi i pasurisë Truall+Ndërtesë — Sip e pasurisë 23833.92 m² — Sip e gjurmës së ndërtimit 5484 m² — Nr. kateve ____ — Nr. pemeve ____

Nord = 4552229.76 East = 507303.26 — KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH) — Nord = 4552229.76 East = 507579.75




Nord = 4551976.64 East = 507303.26 — SH 1: 1000 — Nord = 4551976.64 East = 507579.75

| NR | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI I KUFIRIT | KUFITARI | NIPT/IGJIU |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Veri | | | 17/52, 17/66 | K517260240H |
| 2 | Lindje | | | 17/66, 17/103 | |
| 3 | Jug | | | 17/65/1,16/122 | |
| 4 | Perëndim | | | 17/63,16/122, 17/64 | |

REALIZOI PËR IGJIU
Major Arjana Saliko
KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI
MsC.Ark. Jurgen **ÇOLAKU**

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti__________
DVASHK__________
Nënshkrimi__________
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori__________
Nënshkrimi/ Vula__________

TEKNOLOGJIA E MATJEVE O, Z,G,T

Shënim: Ky plan rilevimi u hartua në zbatim të shkresës të Komandës Mbështetëse nr.1928/1, datë 12.05.2025, bazuar në dokumentacionin hartografik arkivor, HTR, dokumentacionin b/lidhur shkresës dhe ortofoto e vitit 2015-2016.
PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM

MIRATOHET
KOMANDANTI I KOMANDËS MBËSHTETËSE
Gjeneral brigade Aleksandër **PANDO**

**VENDIM**
**Nr. 413, datë 23.7.2025**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR TË PRONËS, ME EMËRTIMIN "GODINA TATIM-TAKSA SHKODËR", ME NUMËR RENDOR 861, DHE PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 421, DATË 2.6.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE (TË PJESSHME) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SHKODËR, TË QARKUT TË SHKODRËS", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër të pronës, me emërtimin "Godina Tatim-Taksa Shkodër", me numër rendor 861, sipas formularit, planit të rilevimit dhe planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për t'u përdorur në fushën e shërbimeve social-kulturore e sportive.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës", të ndryshuar.

3. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i hiqet listës së inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 622, datë 15.9.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave", të ndryshuar, dhe vendimit nr. 818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve", të ndryshuar.

4. Bashkisë Shkodër i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

5. Dorëzimi i pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, bëhet sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe/ose Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Bashkisë Shkodër, ku të përcaktohet sistemimi me ambiente të përshtatshme për punonjësit e institucioneve, që ushtrojnë aktualisht veprimtarinë në këtë godinë.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Bashkia Shkodër dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## 1. FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Institucioni Qendror Shtetëror /Bashkia:Shkodër

Identifikoi dhe Supervizoi pronën: Arban Gjoka Arjan Vasija Specialist

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Alban Preka Zv.Kryetar me vendim delegimi

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

| Nr. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Pasurisë | Emërtesa e pasurisë<br>Adresa | Sip. e pasurisë (m2) | Nga Sip. | | Funksioni për të cilin përdoret prona/ pasuria | Institucioni me përgjegjësi administrative/ pronësi | Institucioni përdorues i pasurisë<br>Statusi juridik i përdorimit | Inventarizuar me VKM | Te dhëna të tjera<br>(Shënime të veçanta) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Truall (m2) | Ndërtesë (m2) | | | | | |
| 861 | 8591<br>Index N-7<br>Vol 42, fq 140 | 2/170 | Truall Ndërtesë | Godina Tatim Taksa<br>Shkoder | 253 | 253 | 253 | Administrative | M.Financave | M.Financave<br>Drejtoria Tatim Taksa Shkoder | VKM 622/2006<br>VKM 818/2006 | Godina ka 5 Kate<br>Sip është 253 m2<br>çdo kat |
| | | | | | | | | | | | | |
| | Totali | | | | 253 | 253 | 253 | | | | | |

Shënim: Sipërfaqja totale do të plotësohet vetëm për prona me shumë komponentë (që përbëhen nga disa pasuri).

GODINA TATIM TAKSA (SHKODER)

## PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET QELLIMI :TRANSFERIM PRONSIE

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| VENDNDODHJA BASHKIA SHKODER<br>DV/ASHK/ZVASHK SHKODER<br>TE DHENAT E PASURISE | ZONAKADASTRALE. 8591 | NUMRI I PASURISE: 2/170 | DATE.01/07/2025 | INDEX HARTE.SH- N- 7 |
| LLOJI I PASURISE:TRUALL | SIP. E PASURISE = 406 m2 | SIP E NDERTIMIT = 406 m2 | NUMRI I KATEVE:5 (KATE) | VOL .9 FQ .140 |

X.459282.488
Y. 4659094.700

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKESHQIPTARE

X.459406.108
Y. 4659094.700




X.459282.488
Y. 4659016.160

X.459406.108
Y. 4659016.160

| NR | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI I KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERI | | | 2/ 554 | | |
| 2 | LINDJE | | | 2/569 | | |
| 3 | JUGU | | | 2/ 625,982 | | |
| 4 | PERENDIMI | | | 2 /989 | | |

DREJTORIA ASETEVE DHE KADASTRES URBANE

TEKNOLOGJIA E MATJEVE

DREJTORI:

PUNOI. SPECIALISTI : ARJAN VASIJA

PUNOI. SPECIALISTI : DORIS BAJRAKTARI

SPECIALISTI _____

DVASHK _________

NENSHKRIMI _______

**KONFIRMOI**

PERGJEGJESI/DREJTORI

NENSHKRIMI/VULA

**Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren: Z-Zyre:O-Ortofoto :G-GPS: S-Station Total: D-MatjeDistancash**

PERCAKTIMI I KUFIRIT

**Kode per Percaktimin e kufirit:P-Perfaqsues i Pronave; K-Kufitaret te Gjithe;KP-Kufitaret Pjeserisht; PB-Perfaqsues Bashkie,HK-Harta Kadastrale;**

SHENIME TE VECANTA : MIRATIM TRANSFERIM PRONSIE NE BAZE TE VKB NR.27 DT.29/05/2025

NR.2/170 SIP.TR- 253 m2 (TRANSFERIM PRONSIE)

NR.2/170 SIP.ND- 253 m2(5 KATE)

PRONARI/BASHKEPRONARET

EMRI : BASHKIA SHKODER

ZV/KRYETAR

Z.ALBAN PREKA

**Kode per teknollogjine e matjeve dhe percaktimi i kufirit : T-Terren:Z-Zyre: O-Ortofoto : G-GPS : S-Stacion Total: D-Matje Distan: P-Perfaqsues i Pronarve: K-Kufitaret te Gjithe:KP-Kufitaret Pjeserisht:PB-Perfaqsues Bashkie,HK-Harta Kadastrale**


Plani i katit perdhe
Siperfaqe ndertese 253 m2
440
620
180
2275
350
155
164.5
325
500
620
440
180
Punoi Specialisti; Arjan Vasija
Punoi Specialisti; Doris Bajraktari
Zv/Kryetar: Z.Alban Preka
REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA SHKODER


Plani i katit te pare e te dyte
Siperfaqe ndertese 253 m2
440
620
180
2275
350
155
164.5
325
500
620
440
180
Punoi Specialisti; Arjan Vasija
Punoi Specialisti; Doris Bajraktari
Zv/Kryetar: Z.Alban Preka



Plani i katit te trete
440
620
180
2275
350
155
164.5
325
500
620
440
180
Punoi Specialisti; Arjan Vasija
Punoi Specialisti; Doris Bajraktari
Zv/Kryetar: Z.Alban Preka
REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA SHKODER


Plani i katit te katert
440
620
180
2275
350
155
164.5
325
500
620
440
180
Punoi Specialisti; Arjan Vasija
Punoi Specialisti; Doris Bajraktari
Zv/Kryetar: Z.Alban Preka
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR


Plani i daljes ne terrace
300
325
500
440
180
Punoi Specialisti; Arjan Vasija
Punoi Specialisti; Doris Bajraktari
Zv/Kryetar: Z.Alban Preka
REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA SHKODER

**VENDIM**
**Nr. 415, datë 23.7.2025**

**PËR NGARKIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, SI AUTORITET KONTRAKTOR, PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT PUBLIK PËR KRIJIMIN E HAPËSIRAVE TË REJA PËR ARKIVIN E KRYEMINISTRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si autoritet kontraktor dhe njësi zbatuese, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për krijimin e hapësirave të reja për arkivin e Kryeministrisë.

2. Në funksion të zbatimit të projektit të përcaktuar në pikën 1, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ngarkohet të kryejë:

a) të gjitha procedurat, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke lidhur edhe kontratën përkatëse, si dhe të ndjekë zbatimin e saj e të projektit përkatës;

b) paraqitjen, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, të kërkesave për miratimin e lejeve përkatëse, në funksion të zbatimit të punimeve.

3. Kryeministria i vendos në dispozicion Fondit Shqiptar të Zhvillimit të dhënat për specifikimet teknike të projektit.

4. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për Kryeministrinë, për vitin 2025.

5. Ngarkohet Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 419, datë 23.7.2025**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 725, DATË 2.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7/1, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun III, të vendimit nr. 725, datë 2.9.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Agjencia kryen gjithashtu detyrat e mëposhtme:

a) Kryen monitorimin e lejeve të ndërtimit, në kompetencë të KKTU-së, nëpërmjet kontrolleve në terren dhe kontrolleve të sistemeve të kamerave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe përgatit raportin përkatës për të informuar Këshillin Kombëtar të Territorit dhe Ujit e autoritetet e tjera, që kanë përgjegjësi në fushën e zhvillimit të territorit mbi kontrollet përkatëse;

b) Organizon aktivitete, ekspozita, panaire, *expo*, si dhe veprimtari të tjera promocionale, kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit dhe përfshirjes së arkitekturës moderne në zhvillimin urban;

c) Financon/bashkëfinancon projektet që lidhen me zhvillimin e territorit dhe promovimin e arkitekturës moderne dhe inovative.".

2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 422, datë 23.7.2025**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KORPORATËS SË INVESTIMEVE SHQIPTARE TË PASURISË SHTETËRORE NR. 867/7, NË ZONËN KADASTRALE 1604, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË INVESTIMIT *"EXPO ALBANIA"***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, "Për Korporatën e Investimeve Shqiptare", të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe në zbatim të shkronjës "a", të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të shoqërisë aksionare "Korporata e Investimeve Shqiptare", me NIPT: M01917011D, të pasurisë shtetërore nr. 867/7, në zonën kadastrale 1604, për realizimin e projektit të investimit *"Expo Albania"*.
2. Autorizimin e shoqërisë aksionare "Korporata e Investimeve Shqiptare", vetë apo nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj, për të vepruar si zhvillues i pasurisë nr. 867/7, në zonën kadastrale 1604, sipas këtij vendimi, në funksion të realizimit të projektit të investimit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i cili ka si qëllim, ndër të tjera, përmbushjen e interesit publik.
3. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për hapjen e procedurës konkurruese për përzgjedhjen e partnerit privat, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare", të ndryshuar, për zhvillimin e pronës nëpërmjet instrumentit të sipërmarrjes, në përputhje me konceptidenë arkitekturore që ka dalë fituese nga konkursi ndërkombëtar.
4. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për negocimin me subjekte private me qëllim lidhjen e kontratës përkatëse për zhvillimin e pronës së transferuar në pronësi, në funksion të realizimit të projekteve të saj të investimit.
5. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj, të kryejë veprimet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimin e territorit apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të projektit të investimit, si dhe të sigurojë regjistrimin në emër të Republikës së Shqipërisë/ /Korporatës të pronës së re shtetërore që do të krijohet në kuadër të projektit të investimit.
6. Në funksion të realizimit të projektit të investimit *"Expo Albania"* dhe në zbatim të pikës 5, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare", të ndryshuar, ngarkohet Korporata e Investimeve Shqiptare të kryejë procesin e konsolidimit të pasurisë nr. 867/7, në zonën kadastrale 1604, në rast se konstatohet mospërputhje midis gjendjes faktike dhe ligjore të pronës.
7. Në funksion të zhvillimit të pronës së përcaktuar në këtë vendim, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar me prishjen e objektit, pjesë e pasurisë nr. 867/7, në zonën kadastrale 1604.
8. Në listat e pronave, që i bashkëlidhen vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, hiqet pasuria shtetërore nr. 867/7, në zonën kadastrale 1604.
9. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e

Investimeve Shqiptare për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 423, datë 23.7.2025**

**PËR FINANCIMIN E FEDERATËS SHQIPTARE TË SKIVE PËR MBËSHTETJE DHE PËRGATITJE PËR PJESËMARRJE NË LOJËRAT OLIMPIKE DIMËRORE *MILANO CORTINA* 2026**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin, në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për Federatën Shqiptare të Skive (FSHS) për mbështetje dhe përgatitje për pjesëmarrje në Lojërat Olimpike Dimërore *Milano Cortina* 2026.

2. Fondi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, transferohet në llogarinë e Federatës Shqiptare të Skive, në një bankë të nivelit të dytë, dhe përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2025 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në llogarinë ekonomike 604 "Transferta të brendshme", në programin buxhetor 08140 "Zhvillimi i sportit".

3. Federata Shqiptare e Skive, brenda muajit gusht 2025, të paraqesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit planin e detajuar dhe të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Federatës Shqiptare të Skive të veprimtarisë, për të cilën do të përdoret ky fond.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Federata Shqiptare e Skive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 424, datë 23.7.2025**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 893, DATË 27.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT 'EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA', NË KUADËR TË LËVIZJES OLIMPIKE SHQIPTARE, DHE PËR AKTIVITETE NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË SPORTEVE TË KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR (KOKSH)", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 1, dhe 15, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 893, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e projektit "Ekipet sportive në shkolla", në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare, dhe për aktivitete në kuadër të ndërkombëtarizimit të sporteve të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Financimin, në masën 1 058 000 000 (një miliard e pesëdhjetë e tetë milionë) lekë, të projektit "Ekipet sportive në shkolla", në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), dhe financimin, në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, të projektit "Ekipet sportive në shkolla", në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), dhe për aktivitete në kuadër të

ndërkombëtarizimit të sporteve, të ndara, si më poshtë vijon:

a) 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2022;

b) 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2023;

c) 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2024;

ç) 200 000 000 (dyqind milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2024, për projektin "Ekipet sportive në shkolla", dhe për aktivitete në kuadër të ndërkombëtarizimit të sporteve;

d) 308 000 000 (treqind e tetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2025, për projektin "Ekipet sportive në shkolla", nga të cilat 298 000 000 (dyqind e nëntëdhjetë e tetë milionë) lekë për projektin "Ekipet sportive në shkolla", dhe 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për shahun, pjesë e të njëjtit projekt.".

b) Në pikën 2, fjalët "... si dhe buxheti i miratuar për vitin 2024 ..." zëvendësohen me "... buxheti i miratuar për vitin 2024, si dhe buxheti i miratuar për vitin 2025 ...".

c) Në pikën 3, fjalët "... si dhe brenda muajit shkurt 2025, përkatësisht për financimet sipas shkronjave "a", "b" dhe "c"..." zëvendësohen me "... dhe brenda muajit shkurt 2025, si edhe brenda muajit gusht 2025, përkatësisht për financimet sipas shkronjave "a", "b", "c", "ç" dhe "d"...".

ç) Në fjalinë e dytë, të pikës 4, togfjalëshi "... muajit shkurt 2025 ..." zëvendësohet me "... muajit gusht 2025 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 425, datë 23.7.2025

## PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 110, DATË 19.2.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2025"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun I, të lidhjes 1, të vendimit nr. 110, datë 19.2.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2025", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Koordinator në sektorin (zyrën) e menaxhimit pranë Zëvendëssekretarit të Përgjithshëm, në Kryeministri, gjithsej, 4 pozicione.".

b) Pikat 10, 16 dhe 23 shfuqizohen.

2. Ngarkohen Kryeministria dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## URDHËR
## Nr. 696, datë 17.7.2025

## PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E KROACISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në pikën 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe e tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontenier të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të $F_0$ prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

| Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja administrative e nivelit 2 | Ndarja administrative e nivelit 3 |
|---|---|---|
| **Osjecko-Baranjska** | **Jagodnjak*** | |
| Vukovarsko-Srijemska | Gradište* | |
| Vukovarsko-Srijemska | Županja* | |
| Vukovarsko-Srijemska | Otok* | |

*Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Kroacisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të

derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

